



Pranuar / Dorezuar Prijmljeno/Prizdato Received/Deliverty		02.12.2021		viti god year
Organ/Njesta Organ/Jedinitca Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot.No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKRIPSHICK	5785/2021		113	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.870/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti-anëtarë si dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.870/2021 të datës 19.10.2021 e parashtruar nga ankuesja me adresë Rruga "Muharrem Fejza", Nr.1/15, Mati, Komuna e Prishtinë, në çështjen juridike "kompensim material", kundër organit të punësimit Policia e Kosovës, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 01.12.2021, mori këtë

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e jashtëafatshme ankesa me numër A.nr.870/2021 e datës 19.10.2021 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Policinë e Kosovës sipas Kontratës së punës me numër të referencës 07/1-01A/0527 të datës 16.06.2014 në vendin e punës "Zyrtare e Lartë për Media" në Njësinë Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, Drejtoria Rajonale e Policisë së Kosovës, me datën 11.06.2021 ankuesja nëpërmjet e-mail-it zyrtarë parashtron kërkesën për kompensim material konform kontratës së punës që e ka me Policinë e Kosovës, tek Drejtori i Drejtorisë Rajonale në Prishtinë.

Me datë 13.07.2021 ankuesja merr përgjigje nga Drejtoria e Personelit, e cila e pa kënaqur me këtë përgjigje me datë 19.10.2021 me numër të protokollit 5088/2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendim ankimor për kompensim material, retroaktiv konform koeficientit 8 të cilën e ka me përshkrim të detyrave i cili është i aprovuar edhe në Ministrinë e Administratës Publike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 25.10.2021 ka kërkuar përgjigje në ankesën e

ankueses nga Policia e Kosovës. Këshilli më datë 10.11.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/18.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesa e ankueses e datës 19.10.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kontrata e punës për ankuesen me numër të referencës 07/1-01A/0527; Përshkrimi i detyrave të punës për vendin e punës "Zyrtare e Lartë për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun"; E-mail-at e datave 26.07.2021, 27.07.2021, 13.07.2021; Titujt e pozitave të punës; Vendimi me numër të lëndës KDNSHC-05/027/2021 i Komisionit Disiplinor; Vendimi për caktim i datës 08.02.2006; Konkursi tetor 2005 për vendin e punës "Zyrtar për Media"; Lista e pagave; E-mail-at e datave 13.07.2021, 12.07.2021, 21.06.2021, 16.06.2021, 11.06.2021 si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjes e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e jashtëafatshme, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, nga provat e lëndës ka konstatuar se ankuesja ne datë 11.06.2021 nëpërmjet e-mail-it zyrtar ka parashtruar kërkesë tek Drejtori i Drejtorisë Rajonale në Prishtinë me pretendim ankimor për kompensim material, konform kontratës së punës që e ka me Policinë e Kosovës, më tutje ankuesja pretendon se me datë 04.09.2015 është nënshkruar dokumenti i përshkrimit të detyrave të punës, ku vendi i punës "Zyrtare e Lartë për Media" është me gradën e koeficientit tetë (8), ndërsa ajo nga ajo datë paguhet me koeficient shtatë (7), e cila pretendon po ashtu se paguhet në kundërshtim me përshkrimin e vendit të punës dhe kontratës, andaj kërkon që të paguhet sipas koeficientit tetë (8) dhe përshkrimit të vendit të punës të nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës nga data 04.09.2015.

Drejtori i Drejtorisë së Personelit me datë 13.07.2021 i përgjigjet ankuese përmes e-mailit te cilën e njofton se „koeficienti i pagës në të cilën është e sistemuar ankuesja është përcaktuar nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publike (DMZP) ish Ministria e Administratës Publik dhe se e njëjta vazhdon të paguhet konform koeficientit ndërsa sa i përket përshkrimit të detyrave të vendit të punës është hartuar koeficienti tetë (8) dhe është aprovuar nga Drejtori i Përgjithshëm i cili përshkrim është hartuar në pajtim me katalogun e vendeve të punës dhe klasifikimin e vendeve të punës (në atë kohë) mirëpo që deri me tani Ministria e Administratës Publike nuk i ka aprovuar me arsyetimin se janë në pritje të aprovimit të Ligjit për Zyrtarët Publik dhe Ligjit të pagave”.

Ankuesja e pa kënaqur me përgjigjen e Drejtorisë së Personelit me datë 19.10.2021 parashtron ankesë me numër të protokollit 5088/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendim ankimor për kompensim material, retroaktiv konform koeficientit tetë (8).

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka konstatuar se nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon



të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil, ndërsa Ligji Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 127 përcakton se: **“1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ; 3. „Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacione, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike (këshillën juridike), afati i parashkrimit nga paragrafi 1 i këtij neni është tre (3) muaj”.**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave në bazë të dëshmive të ofruara ka konstatuar se ankuesja përgjigjen nga Drejtoria e Personelit të Policisë së Kosovës pa njoftim në lidhje me mjetet juridike (këshillën juridike) e ka pranuar përmes e-mailit zyrtar me datën 13.07.2021, ndërsa ankesën me numër protokolli 5088/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e ka parashtruar me datën 19.10.2021, andaj Kolegji vlerëson se parashtrimi i ankesës nga ankuesja me datë 19.10.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafin 1 dhe 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: **„Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ” si dhe 3, „Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacione, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike (këshillën juridike), afati i parashkrimit nga paragrafi 1 i këtij neni është tre (3) muaj”.** Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka vlerësuar se ankuesja nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e ankimimit brenda afatit prej 90 ditësh në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës respektivisht nga data 13.07.2021 kur ankuesja e ka pranuar përgjigjen e datës 13.07.2021 të Drejtorisë së Personelit pa këshillë juridike.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.870/2021

Valentina Kaçandolli Bekteshi

Valentina Kaçandolli
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Malsore Gashi Bajraktari
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- Menaxheres së Personelit në Policinë e Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

